

DFF - Viva Fresh Rajonale

### **Pasqyra e përgjithshme**

Sigurimi i një huaje afatgjatë nga BERZH-i dhe ENEF II për Viva Fresh ("Kompania") për të financuar një pjesë të kostos së blerjes së 100% të aksioneve të Spar Albania ("Caku").

### **ID e projektit 56223**

**Statusi** Në shlyerje

### **Lokacioni**

Rajonal

### **Sektori industrial**

Ushqim dhe Agrobiznes

### **Lloji i Njoftimit**

Privat

### **Afati kohor i projektit**

1. Në eksplorim
2. Ka kaluar Shqyrtimin e Konceptit
3. Ka kaluar Shqyrtimin e Strukturës
4. Ka kaluar Shqyrtimin Përfundimtar
5. Është aprovuar nga Bordi
6. Është nënshkruar
7. Në zbatim
8. Përfunduar

### **Informatat e Kontaktit të Kompanisë**

Xhevdet Rexhepi

[info@vivafresh-rks.com](mailto:info@vivafresh-rks.com)

+38338408888

<https://vivafresh-rks.com/>

Qendra e Logjistikës - Fshati Suhodoll 10000/14000 Lipjan, Kosovë

Të lidhura

- [Formulari i BERZH-it për pyetje](#)
- [Projekte të tjera rajonale](#)
- [Projekte të tjera për Agrobiznes](#)

## **Dokument i Përmbledhjes së Projektit**

**ID e projektit** 56223

**Statusi** Në shlyerje

### **Lokacioni**

Rajonal

### **Spektori industrial**

Ushqim dhe Agrobiznes

### **Lloji i Njoftimit**

Privat

### **Kategoria Mjedisore**

B

### **Data e aprovimit**

06 maj 2025

### **Data e shpalosjes**

01 maj 2025

Sipas seksionit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: "Për projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve ka deleguar autoritetin për aprovim, DPP do të shpaloset në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit për asnjë kundërshtim për një vend anëtar të Bankës në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZH-it."

### **Përshkrimi i projektit**

Sigurimi i një huaje afatgjatë nga BERZH-i dhe ENEF II për Viva Fresh ("Kompania") për të financuar një pjesë të kostos së blerjes së 100% të aksioneve të Spar Albania ("Caku").

### **Objektivat e Projektit**

Projekti do të mbështesë zgjerimin rajonal të Viva Fresh në Shqipëri, përmes blerjes ndërkufitare të zinxhirit të 2-të më të madh të shitjeve me pakicë të ushqimeve dhe pijeve, franshizës të Spar Albania, si dhe përmes programit vijues të investimeve për hapjen e pikave të shitjes të reja dhe rinovimin e disa pikave të shitjes ekzistuese në Shqipëri. Kështu, projekti do të mbështesë zgjerimin e shitjeve me pakicë moderne në Shqipëri dhe integrimin rajonal të zinxhirëve të furnizimit dhe logjistikës për distribucionin dhe shitjet me pakicë të ushqimeve

dhe pijeve. Projekti do të mbështesë edhe masat e zgjeruara për qëndrueshmëri që pritet të shpien në arritjen e certifikimit ndërkombëtar për ndërtesa të gjelbra EDGE "Advanced" (Niveli 2) ose më të lartë për pikat e shitjes të reja dhe të rinovuara nga klienti në Shqipëri dhe Kosovë.

### **Ndikimi i Tranzicionit**

Poentimi ETI: 61

**Kualiteti parësor i NT-së është i integruar**, pasi që projekti mbështet hyrjen e Viva Fresh në tregun e Shqipërisë përmes blerjes së zinxhirit të 2-të më të madh të shitjeve me pakicë në Shqipëri.

**Kualiteti dytësor i NT-së është i gjelbër**, pasi që përqindja e përdorimit të të ardhurave që kualifikohet si GET është 100%.

### **Informata për Klientin**

VIVA FRESH SHPK

Viva Fresh sh.p.k. ("Kompania") është kompani e themeluar në Kosovë ku e zhvillon veprimtarinë e saj që nga viti 2003, duke qenë zinxhiri kryesues i shitjeve me pakicë të ushqimeve dhe pijeve me 111 pika të shitjes në Kosovë, si dhe është gjithashtu e pranishme në Maqedoninë e Veriut me 67 pika të shitjes, përmes filialeve në pronësi të drejtpërdrejtë dhe të plotë të saj: Kit-Go Dooel, e cila (u ble nga Viva Fresh në vitin 2022) është zinxhiri i gjashtë për nga madhësia i shitjeve me pakicë, me 65 pika të shitjes nën brendin e vet Kit-Go; dhe Viva Fresh Maqedoni e Veriut, e cila operon dy pika të shitjes nën brendin Viva Fresh. Spar Albania ("Caku") është zinxhiri i dytë më i madh i shitjeve me pakicë të ushqimeve dhe pijeve në Shqipëri me 43 pika të shitjes të menaxhuara nga vetë kompania dhe 47 pika të shitjes shtesë të menaxhuara si nën-franshiza.

### **Përmbledhja e Financimit të BERZH-it**

25,000,000.00 EURO

Hua senior afatgjatë deri në 25.0 milionë euro e siguruar për Kompaninë bashkërisht nga BERZH-i dhe ENEF II. Transaksioni u aprovua nga Fondi për Zgjerim të Ndërmarrjeve II për Ballkanin Perëndimor ("ENEF II") për bashkëfinancim deri në 3 milionë euro, ose të barasvlershëm me 12% të huasë.

### **Gjithsej Kosto të Projektit**

25,000,000.00 EURO

## **Shtueshmëria**

Shtueshmëria rrjedh nga sa më poshtë vijon:

- BERZH-i ofron dhe mobilizon financime që nuk janë të disponueshme në treg nga burime tregtare me terma dhe kushte të arsyeshme, marrë parasysh risqet specifike që lidhen me një projekt zgjerimi ndërkufitar. Një financim i tillë është i nevojshëm për të financuar tërësisht blerjen.
- Klienti kërkon / përdor ekspertizën e BERZH-it për standardet më të larta mjedisore dhe sociale duke synuar certifikimin EDGE "Advanced" (Niveli 2) dhe EPC B, si dhe duke prezantuar programin e trajnimit me mundësi të barabarta dhe programin e trajnimit të lidershit me theks në rritjen e qasjes për gratë në pozita të menaxhmentit.

## **Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale**

I kategorizuar B (PMS 2014). Risqet mjedisore dhe sociale (MS) që lidhen me blerjen e një biznesi për shitje me pakicë ushqimore dhe shpenzimet kapitale për të financuar ndërtimin e pikave të shitjes të reja janë specifike për lokacionin dhe mund të adresohen lehtësisht përmes masave zbutëse. Kujdesi i duhur për MS është realizuar nga kapacitetet e brendshme të Departamentit të BERZH-it për Mjedis dhe Qëndrueshmëri përmes shqyrtimit të një pyetësi për çështje MS dhe dokumenteve mbështetëse. Klienti ka realizuar kujdesin e duhur të vet për Cakun, duke përfshirë çështjet MS. Si Viva Fresh ashtu edhe Spar Albania janë ish-klientë të Bankës dhe është shqyrtuar edhe Raportimi Vjetor për MS. Viva Fresh i është nënshtruar një Plani për Veprim Mjedisor dhe Social nga një transaksion i mëparshëm dhe është në pajtueshmëri me kërkesat MS të PVMS-së dhe të BERZH-it. Si rezultat i blerjes, Spar Albania do të integrohet në Sistemet për Menaxhim Mjedisor dhe Social të Viva Fresh. Andaj, Spar Albania do të raportojë në Viva Fresh për çështjet MS.

Kujdesi i duhur për MS shqyrtoi kapacitetin për menaxhim, SHS në punë, sigurinë ushqimore, eficientësinë e resurseve, menaxhimin e kontraktorëve, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, SHS në komunitet, si dhe praktikën e punësimit. Përmes procesit të kujdesit të duhur nuk u zbulua asnjë risk i konsiderueshëm ose i paidentifikuar. Risqet që lidhen me punimet për shpenzimet kapitale adresohen përmes një Plani për Veprim Mjedisor dhe Social (PVMS) të dakorduar me Kompaninë. PVMS-ja e ka strukturuar Projektin në përputhje me Kërkesat Mjedisore dhe Sociale të Bankës dhe përfshin menaxhimin e Shëndetit dhe Sigurisë, menaxhimin e kontraktorëve dhe angazhimin e palëve të interesit. Përmes PVMS-së Klienti zotohet të arrijë certifikimin EDGE Advanced për pikat e shitjes të reja të ndërtuara në Shqipëri. Banka do ta monitorojë Projektin përmes shqyrtimit të Raportëve Vjetore Mjedisore dhe Sociale dhe vizitave në terren, nëse do të jetë e nevojshme.

## **Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi me Grante**

**BT 1: Konsulenca juridike** për kujdesin e duhur dhe përgatitjen e dokumenteve financuese, me kosto deri në 80,730 euro, 80% e të cilave të financuara nga fondet për BT të ENEF II dhe 20% nga Kompania.

**BT 2: Këshilla për dizajnin dhe mbështetje për Certifikimin e Ndërtesave të Gjelbra** dhe praktikatat më të mira për ndërtesat e qëndrueshme për shitje me pakicë. Kostoja e detyrës është deri në 70,000 euro, nga të cilat 15% janë kosto të bartura nga Kompania.

### **Informatat e Kontaktit të Kompanisë**

Xhevdet Rexhepi

[info@vivafresh-rks.com](mailto:info@vivafresh-rks.com)

+38338408888

<https://vivafresh-rks.com/>

Qendra e Logjistikës - Fshati Suhodoll 10000/14000 Lipjan, Kosovë

### **Përmbledhja e Zbatimit**

#### **Përditësimi i fundit i DPP-së**

01 maj 2025

#### **Të Kuptuarit e tranzicionit**

[Këtu](#) gjeni informacione të mëtejshme në lidhje me qasjen e BERZH-it për matjen e ndikimit të tranzicionit.

#### **Mundësitë për biznes**

Për mundësitë për biznes ose prokurimet, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH-in (jo lidhur me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet e sektorit shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH-it](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## **Pyetje të përgjithshme**

Pyetjet specifike mund të bëhen duke përdorur [formularin e BERZH-it për pyetje](#).

## **Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)**

**PMS**-ja dhe Kërkesat e lidhura Mjedisore dhe Sociale (KMS) përcaktojnë mënyrat në të cilat BERZH-i zbaton zotimin e vet për të promovuar “zhvillimin e shëndoshë mjedisor dhe të qëndrueshëm”. PMS-ja dhe KMS-të përfshijnë dispozita specifike për klientët që të respektojnë kërkesat e zbatueshme të ligjeve kombëtare për informim dhe konsultim publik, si dhe për të krijuar një mekanizëm për ankesa për të pranuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, në veçanti, në lidhje me performancën mjedisore dhe sociale (MS) të klientit dhe projektit. Në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e risqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të një projekti, BERZH-i kërkon edhe që klientët e vet ta shpalosin informacionin, sipas rastit, në lidhje me risqet dhe ndikimet e projekteve, ose të ndërmarrin konsultime domethënëse me palët e interesit dhe t’i marrin në konsideratë dhe t’u përgjigjen reagimeve të tyre.

Më shumë informata mbi praktikatat e BERZH-it në këtë drejtim jepen në PMS.

## **Integriteti dhe pajtueshmëria**

Zyra e Zyrtaarit Kryesor për Pajtueshmëri (ZZKP) të BERZH-it promovon qeverisjen e mirë dhe siguron që në të gjitha aktivitetet e Bankës të zbatohen standardet më të larta të integritetit, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Kujdesi i duhur për integritetin kryhet për të gjithë klientët e Bankës për të siguruar që projektet të mos paraqesin risqe të papranueshme për integritetin ose reputacionin e Bankës. BERZH-i beson se identifikimi dhe zgjidhja e çështjeve në fazat e vlerësimit dhe aprovimit të projektit, është mjeti më efektiv për të garantuar integritetin e transaksioneve të Bankës. ZZKP-ja luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon në monitorimin e risqeve të integritetit në projekte pas investimit.

ZZKP-ja është gjithashtu përgjegjës për hetimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe sjellje të pahijshme në projektet e financuara nga BERZH-i. Çdokush, si brenda ose jashtë Bankës, që dyshon për mashtrim ose korrupsion, duhet t’i dorëzojë një raport me shkrim Zyrtaarit Kryesor për Pajtueshmëri me e-mail në adresën [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). ZZKP-ja i përcjell të gjitha çështjet e raportuara. Do të shqyrtojë të gjitha çështjet e raportuara. Raportet mund të bëhen në çdo gjuhë të Bankës ose të vendeve ku operon Banka. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

## **Politika për Qasje në Informacion (PQI)**

PQI-ja, e cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2025, përcakton se BERZH-i e shpalos informacionin dhe këshillohet me palët e veta të interesit për të nxitur vetëdijesim dhe të kuptuar më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës për Qasje në Informacion](#) për të kuptuar se çfarë informacioni disponohet nga ueb faqja e BERZH-it.

Kërkesat specifike për informacion mund të bëhen duke përdorur [formularin e BERZH-it për pyetje](#).

### **Mekanizmi i Pavarur për Llogaridhënie të Projektit (MPLLP)**

Nëse përpjekjet për adresim të shqetësimeve mjedisore, sociale ose publike me Klientin ose Bankën janë të pasuksesshme (p.sh. përmes mekanizmit të ankesave në nivel të projektit të Klientit ose përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me menaxhmentin e Bankës), individët dhe organizatat mund të kërkojnë t'i drejtojnë shqetësimet e tyre nëpërmjet Mekanizmit të Pavarur të BERZH-it për Llogaridhënie të Projektit (MPLLP).

MPLLP-ja i shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet e projektit që besohet se kanë shkaktuar (ose ka gjasa të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është: të mbështesë dialogun ndërmjet palëve të interesit të Projektit për t'i zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe të shpalosjes publike; të përcaktohet nëse Banka është në pajtueshmëri me [Politikën e vet Mjedisore dhe Sociale](#) ose dispozitat specifike për projektin të [Politikës së vet për Qasje në Informacion](#); dhe aty ku është e aplikueshme, të adresojë çdo papajtueshmëri ekzistuese me këto politika, duke parandaluar papajtueshmëritë e ardhshme nga ana e Bankës.

Ju lutemi vizitoni [ueb faqen e Mekanizmit të Pavarur për Llogaridhënie të Projektit](#) për të mësuar më shumë rreth MPLLP-së dhe mandatit të vet, si dhe si të [dorëzoni kërkesë](#) për shqyrtim. Përndryshe, kontaktoni MPLLP-në përmes adresës e-mail [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për të marrë udhëzime dhe më shumë informacion mbi MPLLP-në dhe mënyrën e dorëzimit të kërkesës.

## **Dokumentacioni Mjedisor dhe Social**

Dokumentacioni Mjedisor dhe Social nuk është i disponueshëm për këtë projekt.

## **Prokurimi**

Njoftime të përzgjedhura të prokurimit në lidhje me këtë projekt mund të paraqiten më poshtë. Mundësi të mëtejshme prokurimi në lidhje me këtë projekt dhe projekte të tjera, nëse janë të disponueshme, mund të shihen në Portalin për Prokurim të BERZH-it.

## **Ankesat**

Për BERZH-in, Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS), Politika për Qasje në Informacion (PQI) dhe Politika për Llogaridhënie të Projektit (PLLP) mundësojnë zhvillim të shëndoshë dhe të qëndrueshëm në projektet e veta. [Mekanizmi i Pavarur për Llogaridhënie të Projektit \(MPLLP\)](#) trajton ankesat në lidhje me çështjet mjedisore, sociale dhe të shpalosjes që lidhen me investimet e Bankës.

**Deri më tani nuk është parashtruar asnjë ankesë në lidhje me këtë projekt.**